

Syllabus i lëndës

Lënda: FIK'H - III -E Drejta Civile Islame

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 6 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 304

Viti akademik: 2026/2027

Fondi i orëve: 2+2 (Semestri V)

Mësimdhënësi: Prof. ass. Dr. Shefqet Krasniqi

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është njohja me kontratat e rëndësishme në të drejtën Islame duke filluar me kontratën e shitblerjes *akd-ul-bej'* kontratë kjo në të cilën arrihet pajtimi-pëlqimi mes shitësit dhe blerësit gjatë shitblerjes. Qëllim tjetër është njohja me dispozitat që kanë të bëjnë me kontratat, si dhe njohja me mendimet e katër shkollave juridike <në lidhje me kontratat>, mendime të cilat janë shumë të vlefshme për studentët për arsye se këto shkolla juridike kanë sqaruar dispozitat që kanë të bëjnë me kontratat, duke thjeshtësuar dhe shtjelluar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Përmes kësaj lënde synohet të ngritën debate dhe diskutime që do ta ngjallin kërkuesin e studentit. Shpjegimi i lëndës do të bëhet në formë interaktivi mes ligjëruesit dhe studentëve, në mënyrë që studentët të jenë pjesëmarrës aktiv në secilën temë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të lëndës (kursit), studenti do të jetë në gjendje:

Të pajiset me njohuri të përgjithshme por dhe të detajuara për kontratat e ndryshme të së drejtës civile islame.

Të krahasoj mendimet e ndryshme të shkollave juridike për dispozitat e kontratave.

Të diskutoj rreth çështjeve të ndryshme të kontratave duke argumentuar me fakte dhe argumente të sakta nga Kur'ani dhe Suneti.

Të mbroj mendimet dhe qëndrimet e të gjitha shkollave juridike, ashtu siç i mbrojnë pasuesit e secilës shkollë juridike.

Të paraqes mendimin kritik ndaj çështjeve ku ai nuk pajtohet ndaj secilës shkollë juridike.

Të aplikojë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në shërbim të interesit shoqërorë.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, ku do të bëhet stimulimi i studentëve në diskutime interaktive, në mënyrë që të bëjnë pyetje, të japin komente e të bëjnë analiza. Do të ketë edhe teste të vetëvlerësimit në raport me temat që do të shpjegohen. Studentëve do t'iu jepet mundësia që gjatë përgatitjes së lëndës apo seminareve, të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin edhe sugjerimet e tij, për një sukses efikas dhe rezultat të duhur.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Njohja me syllabusin, informata të përgjithshme në lidhje me lëndën dhe procesin e lëndës përgjatë një semestri, njohje me llojet e kontratave, synimin e lëndës etj.

Literatura: (Skripti, material i gatshëm që u jepet studentëve i përgatitur nga mësimdhënësi: Prof. ass. Dr. Shefqet Krasniqi, si dhe literatura shtesë për studentët nga: Mr. Ejup Haziri, *E Drejta Civile*).

Java e dytë: Shitblerja; Përkufizimi i saj; Dispozita e shitblerjes; Ligjshmëria e saj; Vlera e shitblerjes; Urtësia e shitblerjes; Edukata në shitblerje; Pjesët përbërëse në shitblerje si dhe dispozita tjera që kanë të bëjnë me shitblerjen.

Java e tretë: Llojet e shitblerjes: Shitblerja e mallit me mall *Bej'u-l-Mukajedeh*; Shitblerja e valutës me valutë *Bej'u-l-mal bil mal (Es-Sarf)*; Shitblerja e gjërave me valuta *El-Bej'u bin-nukudi ved-derahimi*; Blerja e gjërave më vonë me çmim të menjëhershëm (paradhënie) *Bej'u-Selem*.

Java e katërt: Shitblerja e detyruar; Shitblerja e pavlefshme; Llojet e shitblerjes s pavlefshme; Shitblerja e mallit të ekzistuar; Mashtrimi në shitblerje; Shitblerja e hurmave në pallmë; Shitblerja e ndyrësirave; Shitblerja e plehit të shtazëve; Shitblerja e ujit; Shitblerja e mallit të tjetrit.

Java e pestë: E drejta e përzgjedhjes; E drejta e shitblerjes në mexhllis; E drejta e vënies kush; E drejta e përzgjedhjes për të metën; Marrëveshja mes dy vetave për ta dëmtuar të tretin; Monopolizimi; Ryshfeti; Paradhënia e parave; Pritja e tregtarëve; Çmimorja; Anulimi i shitblerjes; Prodhimi me porosi; Shitblerja me rata-këste.

Java e gjashtë: Kamata; Përkufizimi i kamatës; Dispozita e kamatës; Kronologjia e ndalimit të kamatës; Urtësia e ndalimit të kamatës; Llojet e kamatës; *kamata e shtesës dhe e vonesës*; Bankat; Funksionimi i bankave islame.

Java e shtatë: Qiraja; Përkufizimi i qirasë; Ligjshmëria e qirasë; Urtësia e qirasë; Pjesët përbërëse të qirasë; Kushtet e vlefshmërisë së qirasë; Kur priset kontrata e qirasë; Në çka lejohet qiraja.

Java e tetë: Huazimi; Përkufizimi i huazimit; Dispozita e huazimit; ligjshmëria e huazimit; Pjesët përbërëse të huazimit; Kushtet e vlefshmërisë së huazimit; Llojet e huazimit; Koha kur kthehet sendi i huazuar; Detyrimi i kthimit të sendit të huazuar; Dëshmëpërblimi për huazim.

Java e nëntë: Borxhi; Përkufizimi i borxhit; Ligjshmëria e borxhit; Dispozita e borxhit; Obligimi i kryerjes së borxhit; Pritja dhe afatizimi i borxhit; Kushtet e borxhit; Në çka lejohet borxhi; Kushtëzimi i afatit në borxh dhe dispozita të ndryshme lidhur me borxhin; Sigurimi dhe çështje të ndryshme që lidhen me sigurimin.

Java e dhjetë: Ortakëria (partneriteti); Ligjshmëria e ortakërisë; Urtësia e ortakërisë; Pjesët përbërëse të ortakërisë; Llojet e ortakërisë: *ortakëria e pabarabartë, ortakëria e barabartë*; Ortakëria në zanat; Ortakëria në pozitë; Prishja e kontratës së ortakërisë.

Java e njëmbëdhjetë: Marrëveshja për tregti; Përkufizimi i marrëveshjes për tregti; Ligjshmëria e marrëveshjes për tregti; urtësia e marrëveshjes për tregti; Pjesët përbërëse të marrëveshjes për tregti; Llojet e saj; Kushtet e saj; Dispozita që ndërlidhen me marrëveshjen për tregti; Prishja e kontratës.

Java e dymbëdhjetë: Vakëfi; Argumenti i ligjësimit të vakëfit; Dispozita e vakëfit; Qëllimi i vakëfit; Llojet e vakëfit; Kushtet e vakëfit; Lënda e vakëfit; Vlefshmëria dhe regjistrimi i vakëfit; Dallimi mes vakëfit dhe sadakasë; Ndryshimi dhe tjetërsimi i vakëfit; Vakëfi i vasijetit.

Java e trembëdhjetë: Vasijeti (testamenti); Argumenti i ligjësimit të testamentit; Kushtet e testamentit; Kushtet e testament-lënësit; Kushtet e testament-pranuesit; Kushtet e sendit të lënë testament; Llojet e testamentit; Kur shpallet i pavlefshëm testamenti; Vlefshmëria e testamentit (vasijetit).

Java e katërbëdhjetë: Uzurpimi; Dispozita e uzurpimit; Pasojat nga uzurpimi; Rikthimi i sendit të uzurpuar; Fëmija i humbur; Malli i humbur; Të mbjellurat; Gjallërimi i tokave të shkreta dhe dispozita tjera lidhur me këto çështje të ndryshme.

Java e pesëmbëdhjetë: Provimi final.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrja dhe aktiviteti gjate orës: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final **50 pikë**

Totali: **100 pikë**

Literatura obliguese:

Skripti, material i gatshëm që u jepet studentëve i përgatitur nga mësuesi: Prof. ass. Dr. Shefqet Krasniqi.

Literatura plotësuese:

Mr. Ejup Haziri, *E Drejta Civile*, Prishtinë, 2014, botuar nga Fakulteti i Studimeve Islame.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar në vijimin e ligjëratave, ngase për secilën orë mbahet evidenca. Nga studentët kërkohet t'u përmbahen rregullave dhe kodit të mirësjelljes.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.